



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 23 mars 2020
Nr. ref.:RK 1535/20

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI192/19

Parashtrues

Naser Shala

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit CA.nr. 1802/2019 të
Gjykatës së Apelit të Kosovës, të 6 majit 2019**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare, dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Naser Shala prej Rahovecit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin CA.br. 1802/2019 të Gjykatës së Apelit, të 6 majit 2019.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktvendimit të kontestuar, me të cilin sipas pretendimeve të parashtruesit janë shkelur të drejtat e tij të garantuara me nenet 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare]], 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 46 [Mbrojtja e Pronës], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesioneve] dhe 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Kushtetuta), dhe nenet 6 (E drejta për një proces të rregullt), 1 Protokoll nr. 1 (Mbrojtja e pronës) i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Ligji) dhe rregullin 32 të Rregullores së Punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e Punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 24 tetor 2019, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Gjykata).
6. Më 31 tetor 2019, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Selvete Gërxhaliu Krasniqi (kryesuese), Bajram Ljatifi dhe Radomir Laban.
7. Më 5 nëntor 2019, Gjykata i dërgoi kopje të kërkesës Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe e njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj të plotësojë formularin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të sqarojë kërkesën dhe të paraqet dokumente të tjera të nevojshme përcjellëse.
8. Më 11 nëntor 2019, shkresa e njoftimit e dërguar te parashtruesi i kërkesës iu kthye Gjykatës me vërejtje se parashtruesi i kërkesës nuk gjendet në adresën e cila ishte cekur në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës.
9. Më 14 nëntor 2019, Gjykata përsëri i dërgoi shkresën e njoftimit parashtruesit të kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe i kërkoj të plotësojë formularin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës, të sqarojë kërkesën dhe të paraqet dokumente të tjera të nevojshme përcjellëse.
10. Më 20 nëntor 2019, shkresa e njoftimit e dërguar te parashtruesi i kërkesës iu kthye Gjykatës me vërejtje se parashtruesi i kërkesës nuk gjendet në adresën e cila ishte cekur në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës.

11. Më 26 shkurt 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit raportues, Kolegji shqyrtues i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

12. Më 20 prill 2018, [me Aktvendimin CP.nr. 258/2017] Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec vërtetoi se parashtruesi i kërkesës me kryerjen e punimeve të dheut kishte dëmtuar murin rrethues i cili gjendet në ngastrën në pronësi të vëllait të tij, i cili edhe ngriti padi ndaj parashtruesit të kërkesës. Me të njëjtin Aktvendim, Gjykata Themelore e urdhëroi parashtruesin e kërkesës që të ndërpresë punimet dhe të mos vazhdojë me to dhe e detyroi parashtruesin e kërkesës të paguajë shpenzimet gjyqësore.
13. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore *“për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore”*.
14. Më 29 qershor 2018, Gjykata e Apelit [me Aktvendimin Ac. nr. 2892/2018] aprovoi ankesën e parashtruesit si të bazuar, prishi në tërësi aktvendimin e shkallës së parë dhe ia ktheu atë Gjykatës Themelore për rivendosje.
15. Më 15 janar 2019, [me Aktvendimin CP.nr. 249/2018] Gjykata Themelore në Gjakovë – Dega në Rahovec në procedurë të përsëritur, përsëri vërtetoi se parashtruesi i kërkesës me kryerjen e punimeve të dheut kishte dëmtuar murin rrethues i cili gjendet në ngastrën në pronësi të vëllait të tij, i cili edhe ngriti padi ndaj parashtruesit të kërkesës. Me të njëjtin Aktvendim, Gjykata Themelore e detyroi parashtruesin e kërkesës që murin rrethues ta rindërtojë dhe ta kthejë në gjendjen e mëparshme, si dhe në të ardhmen të përmbahet nga çdo lloj pengimi si i këtillë.
16. Në një datë të pacaktuar, parashtruesi i kërkesës ka paraqitur ankesë në Gjykatën e Apelit kundër Aktvendimit të Gjykatës Themelore, *“për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale”*.
17. Më 6 maj 2019, Gjykata e Apelit [me Aktvendimin AC. nr. 1802/2019] e hodhi poshtë si të pabazuar, ankesën e parashtruesit dhe në tërësi e vërtetoi vendimin e Gjykatës Themelore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

18. Parashtruesi i kërkesës, në deklaratën e tij para Gjykatës pohoi se me aktvendimet e kundërshtuara të Gjykatës Themelore dhe të Gjykatës së Apelit atij i janë shkelur të drejtat e garantuara nga nenet 22, 31, 46, 49 dhe 53 të Kushtetutës, si dhe nenet 6 dhe 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.
19. Parashtruesi i kërkesës, pasi sqaroi kronologjinë se si gjykatat e rregullta kanë vendosur me vendime gjyqësore për çështjen e tij, pretendon shkelje të Kushtetutës dhe KEDNJ duke shpjeguar se, *“Me Aktvendimin e Gjykatës Themelore [...] dhe Aktvendimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës [...], është*

legjitimuar padrejtësia dhe vendosja e njëanshme e Gjykatës së Apelit të Kosovës. Nuk ka pasur asnjë arsye që në riprocedurë të ndryshohet Kolegji gjykues. Ai ndryshim sjellë në dyshim ligjshmërinë dhe sigurinë juridike, ashtu me vendimet e atakuara me janë shkelur të drejtat dhe garancitë kushtetuese”.

20. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij ka cekur adresën në të cilën mund ta kontaktojë Gjykata në lidhje me procedimin e mëtutjeshëm të çështjes.

Pranueshmëria së kërkesës

21. Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të Punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.

23. Gjykata gjithashtu i referohet neneve 22.4 dhe 48 të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 22 [Procedimi i kërkesës]

4. Nëse kërkesa ose përgjigja në kërkesë nuk është e qartë ose e kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se pesëmbëdhjetë (15) ditëve për të qartësuar ose plotësuar kërkesën, përkatësisht përgjigjen në kërkesë. Gjyqtari raportues ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, nëse kjo është e nevojshme për të vlerësuar lejueshmërinë dhe themelësinë e kërkesës.

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë.

24. Për më tepër, Gjykata merr në konsideratë rregullin 32 [Parashtimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së Punës, që parasheh:

"(2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës ..."

25. Gjykata gjithashtu merr në konsideratë rregullin 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës] të Rregullores së Punës, që parasheh:

"[...] Gjykata mund të vendosë ta refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave nga Gjykata ndaj palës që të plotësojë ose të qartësojë kërkesën [...]."

26. Sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat e tij të garantuara nga nenet 22, 31, 46, 49 dhe 53 të Kushtetutës, dhe nenet 6, 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ.
27. Meqenëse parashtruesi i kërkesës kundërshton Aktvendimin AC.nr. 1802/2019 të Gjykatës së Apelit, Gjykata kujton se parashtruesi i kërkesës është i detyruar të mbështesë me dokumente të vlefshme këto pretendime të tij dhe të paraqesë kërkesën zyrtare të Gjykatës të plotësuar, si dhe prova për pranimin e Aktvendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit.
28. Gjykata rikujton, para së gjithash, se në rastin konkret sipas nenit 22 të Ligjit, Gjykata në dy raste i ka kërkuar parashtruesit të kërkesës *"të plotësojë formularin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës për të sqaruar kërkesën dhe të sigurojë prova të tjera për pranimin e Aktvendimit të kundërshtuar të Gjykatës së Apelit"*.
29. Më tej, Gjykata konstaton se në bazë të fletë-kthesave, më 11 nëntor 2019 dhe 20 nëntor 2019, parashtruesit të kërkesës i është dërguar njoftimi dhe që të dy njoftimet ishin kthyer me vërejtjen se parashtruesi i kërkesës nuk jetonte në adresën e cekur në kërkesë.
30. Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk ka dhënë adresën e saktë dhe nuk i është përgjigjur kërkesës së Gjykatës për paraqitjen e dokumentacionit themelor, pa të cilin asnjë autoritet publik i Republikës së Kosovës nuk mund të ndërmarrë ndonjë veprim.
31. Gjykata thekson se nuk është gjykatë e mbledhjes së fakteve dhe barra e provës i mbetet parashtruesit të kërkesës i cili nuk i plotësoi kërkesat procedurale të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të Punës (Shih, për shembull, rasti nr. K103/15, *Parashtruesi Hasan Beqiri*, Vendimi për hedhje poshtë të kërkesës i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, i datës 5 qershor 2015).
32. Prandaj, Gjykata vëren se, përveç kërkesës së tij të përgjithshme dhe abstrakte, parashtruesi i kërkesës, nuk i ka parashtruar Gjykatës asnjë nga dokumentet e kërkuara, edhe pse Gjykata e ka kërkuar këtë nga ai dy herë.
33. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa e çështjes është e paplotë sepse parashtruesi i kërkesës nuk e ka cekur adresën e tij në mënyrë të saktë dhe

nuk ka paraqitur dokumentet përcjellëse të kërkuara nga Gjykata me të cilat do të dëshmohet pretendimet e tij.

34. Në përmbledhje, Gjykata konkludon se kërkesa nuk i plotëson kërkesat procedurale për shqyrtim të mëtejshëm të parashikuar nga rregulli 35 i Rregullores së Punës. Meqenëse parashtruesi i kërkesës nuk e ka plotësuar formularin e kërkesës së Gjykatës Kushtetuese të Kosovës dhe nuk ka paraqitur dokumentet e nevojshme, kërkesa duhet të refuzohet në procedurë të shkurtër, në përputhje me rregullin 35 (5) të Rregullores së Punës.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 7 të Kushtetutës, me nenet 22.4 dhe 48 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 29, 35 (5) të Rregullores së Punës, më 26 shkurt 2020, njëzëri

VENDOS


- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi

Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arta Rama-Hajrizi